



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-60
Prishtinë, më 06 prill 2009, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 6 PRILL 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku dhe Slllobodan Petroviq, kurse munguan: Xhavit Haliti, Ibrahim Gashi dhe Xhezair Murati.

Nga kryetarët e grupeve parlamentare ishin të pranishëm: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Lulëzim Zeneli, Ardian Gjini, Myfera Shinik dhe Slllvisa Petkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu, kurse nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Shefqet Rexhepi, Xheladin Hoxha, Selman Ymeri, Naim Abazi dhe Arsim Avdiaj.

Nga OSBE- ja, Floriana Shala.

.

Mbledhjen e drejtoi Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje. Ai propozoi edhe dy pika shtesë.

Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit të Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 31 mars 2009,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme të Kuvendit,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 31 mars 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 31 mars 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme të Kuvendit

2.1 Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me kërkesën e Presidentit dhe të Kryeministrit për mbajtjen e një seance solemne të Kuvendit të Kosovës, për të shënuar njëvjetorin e miratimit të Kushtetutës së Republikë së Kosovës.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, vendosi që seanca solemne të mbahet më 8 prill 2009, në orën 10:00.

2.2 Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që seanca e ardhshme e Kuvendit të mbahet më 16 prill 2009, me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.
2. Koha për pyetje parlamentare.
3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 2004/50 për veprimtarinë private në shëndetësi,

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armët,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 03/L-090 për partneritet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik për aktivitetet e prokurimit publik në Kosove për vitin 2008,
10. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2008, dhe
11. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e një anëtari jo ekzekutiv të Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i kërkesës së 6 deputetëve për debat në Kuvend rreth procesit të privatizimit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga Agjencia e Privatizimit që ta përgatisë një informatë për procesin e privatizimit, sipas kërkesës së grupit të deputetëve.
2. Informata e kërkuar, sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi të përgatitet dhe Kuvendit t'i dërgohet sa më shpejt.

3.2 Shqyrtimi i propozimit të Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03L-040 për vetëqeverisjen lokale

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit konstatoi se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për procedim me propozimin e organizatave të Shoqërisë Civile: KDI, KCIC, Syri i Vizionit, SDE dhe INPO për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-040 për vetëqeverisjen lokale.

Arsyetim

Në bazë të nenit 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtën për nismë për të propozuar ligje, përveç të tjerëve, e kanë edhe dhjetë mijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Megjithatë, deri më tani nuk është nxjerrë ligj i veçantë që përcakton kushtet dhe mënyrën e parashtrimit të projektligjeve nga qytetarët.

Njëherësh, propozimi i Shoqërisë Civile ka të bëjë me ndryshimin e legjislacionit me interes vital, që i nënshtrohet procedurës së veçantë të miratimit (neni 81 i Kushtetutës).

3.3 Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për afat shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguri nukleare

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e dy projektligjeve:
 - Projektligji për bujqësi dhe zhvillim rural, dhe
 - Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguri nukleare.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për sigurimin e kushteve të punës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë kërkesën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.5 Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për të hyrat dhe shpenzimet e RTK-së, për vitin 2007

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që, megjithatë, ta rishqyrtojë Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për të hyrat dhe shpenzimet e Radio-Televizionit të Kosovës për vitin 2007 dhe Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimet për seancë plenare.
2. Kërkohe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm që, në pajtim me ligjin, Kuvendit t'ia dërgojë raportin për auditimin e plotë të pasqyrave financiare të Radio-Televizionit të Kosovës për vitin 2008.
3. Kërkohe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm që raportin, sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi, t'ia paraqesë Kuvendit në afatin sa më të shpejt.

3.6 Shqyrtimi i propozimeve për formimin e Shoqatës së Miqësisë Francë-Kosovë

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimet e grupeve parlamentare për formimin e Shoqatës së Miqësisë Francë-Kosovë, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet nisma e grupeve parlamentare për formimin e Shoqatës së Miqësisë Francë-Kosovë, në këtë përbërje:
 1. Hydajet Hyseni –GP PDK,
 2. Ramadan Avdiu –GP PDK,
 3. Sabri Hamiti - GP LDK,
 4. Lutfi Haziri - GP LDK,
 5. Ibrahim Makolli – GP AKR,
 6. Mark Krasniqi - GP LDD,
 7. Bajram Kosumi – GP AAK,
 8. Slllobodan Petroviq – GP SLS, dhe
 9. Xhezair Murati –GP “ 7+”.

3.7 Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë së NATO-s

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën për pjesëmarrje në Asamblenë e NATO-s, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet pjesëmarrja e tre deputetëve të Kuvendit: Naim Malokut, Xhavit Halitit dhe Slllobodan Petroviqit në Asamblenë e NATO-s, që do të mbahet në Oslo të Norvegjisë, prej 22 deri më 26 maj 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë (30%) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri për lejimin e udhëtimit në Ohër

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, në përbërje: Zafir Berisha, Gani Geci, Bojan Stojanoviç dhe Zylfi Merxha, si dhe Blerina Pula, nga stafi mbështetës i Komisionit, në Ohër, prej datës 5 deri më 8 prill 2009.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë (30%) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

3.9 Kërkesa e deputetit Ibrahim Gashi për lejimin e kompensimit shtesë për udhëtimin zyrtar në Bullgari

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi shtesë për udhëtimin dhe qëndrimin zyrtar të deputetit Ibrahim Gashi, në Bullgari, prej datës 25 deri më 27 mars 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i mbulohen në vlerën që dëshmohet në faturën e hotelit.

3.10 Njoftimi lidhur me skadimin e mandatit të tre anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës të iniciojë procedurën për propozimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
2. Propozimet, sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi, t'i dërgohen Kuvendit në afatin sa më të shpejt .

3.11 Njoftim lidhur me skadimin e mandatit të një anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Kryesia, pasi shqyrtoi njoftimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Miratohet kërkesa e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e një anëtari të këtij këshilli.
2. Ngarkohet Seksioni i Personelit t'i marrë të gjitha veprimet procedurale dhe të shpallë konkursin për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/12 për Shërbimin Civil të Kosovës

3.12 Njoftim lidhur me rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian nga tryeza e rrumbullakët, në temën: “ Respektimi i të drejtave të komuniteteve në Kosovë në raport me integritet evropian”.

Kryesia u njoftua me rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian.

3.13 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Jashtme për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit dhe të qëndrimit të delegacionit të Komisionit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

- 1 Miratohet kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit dhe të qëndrimit të delegacionit të Komisionit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë.
- 2 Kuvendi do t'i mbulojë shpenzimet e akomodimit dhe të qëndrimit të delegacionit të Komisionit të Jashtëm të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në përbërje prej 5-6 anëtarëve, i cili do të qëndrojë në Prishtinë, prej 12 deri më 14 prill 2009.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**